



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORI

Nr. 1440 Prot.

Tiranë, më 29.10.2024

URDHËR

Nr. 49, Datë 29/10/2024

PËR

**CAKTIMIN E DATËS SË FILLIMIT TË PROCESIT ZGJEDHOR DHE TË DATËS  
SË ZHVILLIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR PËRGJEGJËS TË NJËSIVE BAZË  
KMDP, KANTO DHE SKULPTURË NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Mbështetur në nenin 36, pika 7 dhe nenin 39 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Urdhrin e MAS nr. 101, dt. 13/03/2024, “Për procesin zgjedhor për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, në nenin 22, pika 6 dhe në nenin 27, pika 2 të Statutit të Universitetit të Arteve, në nenin 4, pika 12 dhe nenin 5, pika 3 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Arteve”, miratuar me VSA nr. 17, datë 29.03.2024 si dhe bazuar faktin që drejtuesit e njësive bazë KMDP, Kanto dhe Skulpturë janë të komanduar në këtë detyrë, bazuar në rezultatin e zgjedhjeve të mbajtura në rang institucional më 21 Qershor 2024,

URDHËROJ:

1. Dita e fillimit të procesit zgjedhor për Përgjegjës të Njësive Bazë KMDP, Kanto dhe Skulpturë në Universitetin e Arteve është data **13 Nëntor 2024**.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për Përgjegjës të Njësive Bazë KMDP, Kanto dhe Skulpturë në Universitetin e Arteve është data **13 Dhjetor 2024**.
3. Ky urdhër i përcillet për njohje dhe zbatim, Fakultetit të Muzikës, Fakultetit të Arteve të Bukura si dhe një kopje e tij i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
4. Ky urdhër të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

